



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1043/1 Prot.

Tiranë, më 23.10. 2023

V E N D I M

Nr. 210, datë 23 .10. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 186, datë 25.09.2023, të paraqitur nga z. F.N, në emër të Shoqatës “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa”, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Nga aktet e administruara, rezulton se, z. F.N, ka paraqitur në emër të Shoqatës “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa”, një ankesë kundër Spitalit Rajonal Shkodër. Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ai parashtron se:

Rampa tek hyrja kryesore nuk përshtatet me standardet e përcaktuara, e cila duhet të jetë 5% për personat që përdorin karrocet. Aktualisht rampa nuk është funksionale dhe duhen dy persona që të shoqërojnë personin me aftësi të kufizuar. Pjerrësia është shumë e mprehtë dhe materiali i ndërtimit është i rrëshqitshëm, sidomos në ditët me shi. Përveç kësaj, mungon parmaku mbrojtës nga njëra anë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)**është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;**”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Bazuar në aktet e depozituara nga pala ankuese, rezulton se, Shoqata “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa”, është regjistruar si person juridik me vendimin nr.132, datë 09.04.1999, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Shkodër. Në bazë të statutit të depozituar, rezulton se, të drejtën për të përfaqësuar Shoqatën në marrëdhënie me të tretët, e ka Presidenti. Referuar vendimit gjyqësor dhe statutit të depozituar nga pala ankuese, nuk rezulton që z. F.N, të mbajë pozicionin e Presidentit të Shoqatës “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa”. Nuk rezulton që bashkëlidhur ankesës të jetë depozituar ndonjë akt përfaqësimi lëshuar nga përfaqësuesi ligjor i Shoqatës “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa”, nëpërmjet të cilës autorizohet z.F.N, për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD-së, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e

depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet gjithashtu se: *“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimitimin e pales që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”*.

Në bazë të nenit 32, pika 1, germa “b”, të LMD, Komisioneri ka kompetencë, të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të çenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”*.

Nga aktet e administruara rezulton se, Shoqata “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr.132, datë 09.04.1999, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Shkodër. Bazuar në ankesën e paraqitur Shoqata nuk pretendon se është çenuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara për shkak të mosplotësimit të standardeve të aksesueshmërisë së rampës në Spitalin Rajonal Shkodër. Referuar statutit të depozituar nga pala ankuese, Shoqata “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa” është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që, ndër të tjera, të nxisë veprimtarinë sociale të shprehur nëpërmjet ndihmesës njerëzore, në vepra bamirësie, në emancipimin e gruas dhe me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Neni 34, i Kodit të Procedurave Administrative sanksionon se: *“1. Një organ publik, palë në një procedurë administrative, vepron nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të përcaktuar sipas ligjit ose titullarit të institucionit, kur nuk ka përfaqësues ligjor të caktuar. 2. Zotësia për të vepruar, në një procedurë administrative, e personave të tjerë rregullohet sipas legjislacionit në fuqi.”*

Referuar nenit 31, të Kodit Civil, personi juridik, vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut, të cilët shprehin vullnetin e tij. Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik.

Nga aktet e administruara rezulton se, të drejtën për të përfaqësuar Shoqatën “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa”, e cila, në ankesën objekt shqyrtimi është në cilësinë e palës ankuese, e ka Presidenti. Nuk rezulton që z. F.N, i cili ka nënshkruar ankesën në emër të Shoqatës “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa”, të jetë emëruar President i Shoqatës apo të jetë i pajisur me një akt përfaqësimi që i jep të drejtën për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, të lëshuar nga organi që ka të drejtën të përfaqësojë personin juridik.

Në datën 26.09.2023, nëpërmjet postës elektronike (në adresën e *e-mailit* të vendosur në formularin e ankesës), i është kërkuar z. F.N, i cili rezulton që të ketë nënshkruar ankesën në emër të Shoqatës “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa”, që të plotësojë ankesën, duke depozituar kopje të përditësuar të akteve të Shoqatës ku ai të figurojë në cilësinë e përfaqësuesit ose një akt përfaqësimi të lëshuar nga përfaqësuesi ligjor i Shoqatës, nëpërmjet të cilit z. Nocchi autorizohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi para Komisionerit. Subjekti nuk i depozitoi aktet e kërkuara brenda afatit, por as nuk kërkoi shtyrjen e këtij afati, në rast se për arsye objektive ishte në kushtet e pamundësisë për të respektuar afatin e vendosur për depozitim e akteve.

Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se, z. Fabrizio Nocchi, nuk legjitimohet për vepruar në emër dhe për llogari të Shoqatës “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa” në paraqitjen e ankesës objekt shqyrtimi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nuk mund të pranohet për shkak se mungesa e legjitimitetit të z. F.N, për vepruar në emër dhe për llogari të Shoqatës “Opera della Divina Providenza Madoninna del Grappa” në paraqitjen e ankesës objekt shqyrtimi, e bën ankesën të papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në referim të nenit 32, pika 1, gërma “c”, ku sanksionohet se: *“1. Komisioneri ka kompetencë: c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji.”*, Komisioneri mund të procedojë me ndjekjen kryesisht të çështjes në lidhje me pretendimet e ngritura për mungesën e aksesueshmërisë në Spitalin Rajonal Shkodër.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 186, datë 25.09.2023, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim